



**RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT
TË MJEDISIT NË KOMUNËN E
FERIZAJIT - 2021**

Botues: EC Ma Ndryshe
Rr: Fehmi Lladrovci 94, Prizren
Bulevardi Nënë Tereza 30B H1 Nr. 5, Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 03 224 967

Ky dokument është realizuar nga EC Ma Ndryshe, i mbështetur nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida) përmes Programit të saj "Human Rightivism" zbatuar nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit - CDF. Përmbajtja dhe pikëpamjet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të donatorëve



Ky raport është një përpjekje e re e strukturuar e shoqërisë civile për të adresuar e trajtuar përgjegjësitë e organeve kompetente të Qeverisë Lokale, përkatësisht përgjegjësitë e Komunave karshi 7 aspekteve mjedisore që rregullohen me kornizën ligjore të vendit.

Organet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit janë të rregulluara në forma të ndryshme në Komunitatet e Kosovës. Disa nga komunitetet kanë drejtoritë të dedikuara për mbrojtjen e mjedisit, ndërsa disa kanë sektore në kuadër të drejtorive për planifikim apo zyrtarë përgjegjës për çështje mjedisore.

Metodologjia e ndjekur nga EC Ma Ndryshe për përpilimin e këtij raporti merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, si:

- Ligji nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit
- Ligji nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës
- Ligji nr.03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja
- Ligji nr.2003_3 për Pyjet e Kosovës
- Ligji nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës
- Ligji nr.04/L-060 për Mbeturina
- Ligji nr.06/L-035 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike
- Ligji nr.03/L-119 për Produktet Biocide dhe Shtojcat
- Ligji nr.02/L-53 për Gjuetinë
- Ligji nr.04/L-197 për Kimikate
- Ligji nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor
- Ligji nr.04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit

Ndërsa aspektet kryesore që ligjet e lartshënuara rregullojnë janë:

- Organet institucionale
- Kapacitetet njerëzore
- Dokumentet e Planifikimit dhe Menaxhimit Mjedisor
- Pjesëmarrja publike
- Të dhënat Mjedisore
- Mbikëqyrja dhe raportimi
- Licencimi, lejet dhe pëlqimet mjedisore

Mbi këtë bazë përmbajtja e këtij raporti tenton që të mbulojë aspektet kryesore që legjislacioni në fuqi adreson, si:

- Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor*
- Korniza ligjore*
- Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit*

*Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor
Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave
Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike
Licencimi dhe lejet mjedisore*

Gjetjet e këtij raporti në kapituj të caktuar kanë identifikuar mangësitë aktuale në sektorin e mjedisit, që kërkojnë vëmendje më të shtuar nga autoritetet komunale, me qëllim të përmirësimit të procesit të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor. Gjithashtu ato janë validuar nga zyrtarët përkatës komunalë, si pasqyrim i gjendjes reale në sektorin e mjedisit. Njëherësh kanë theksuar se burimet njerëzore dhe financiare nuk janë në nivel të mjaftueshëm, gjë që mbase reflektohet edhe në gjendjen aktuale mjedisore.

Në fund janë adresuar edhe disa rekomandime me qëllim të përmirësimeve dhe plotësimeve në proceset e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor, drejt arritjes së rezultateve më të qëndrueshme në sektorin e mjedisit dhe mbrojtjen e resurseve natyrore.

GJETJET E RAPORTIT

1. Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Ferizajt organi përgjegjës për planifikim dhe menaxhim mjedisor është Zyra për Mbrojtjen e Mjedisit që funksionon në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit dhe e Mjedisit.

Stafi i Zyres për Mbrojtje të Mjedisit është i pamjaftueshëm sepse në këtë sektor është i angazhuar vetëm një zyrtar.

Organi komunal	A është themeluar?	Emri zyrtar	Fuqia aktuale punëtore
Drejtoria	Po	DUMM (Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit)	/
Sektor	Po	Zyra për Mbrojtjen e Mjedisit (me staf të pamjaftueshëm)	1
Zyrtarët	Po	Minir Haxhimusa	1

Numri i angazhuar i shërbyesve civil sipas deklaratave të zyrtarit të ZMM nuk është i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore dhe sipas tij shërbyesi civil në këtë dikaster ka profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore, ku nga shkalla 1 (aspak) deri në 5 (shkëlqyeshëm) ka dhënë vlerësimin 5.

ZMM ka bërë të ditur se gjatë vitit 2021 për punonjësit e këtij sektori nuk janë organizuar trajnime rreth kornizës ligjore nga niveli qendror, komuna apo ndonjë organizatë tjetër. Gjithashtu në vitin 2021 nuk është organizuar asnjë trajnim rreth çështjeve mjedisore për stafin e ZMM nga niveli qendror, komuna apo ndonjë organizatë tjetër.

Zyrtari ka bërë të ditur poashtu se ky dikaster shfrytëzon udhëzuesit administrativ të lëshuar nga niveli qendror:

- Udhëzuesin Administrativ 1/2017 për dhënien e lejeve mjedisore komunale;
- Rregulloren komunale të emëruar “Rregullore Mbi Mbrojtjen e Mjedisit” e miratuar më 13.07.2009 nga KK Ferizaj

* * * * *

Statistikat Kryesore - 2021:

1. Numri i zyrtarëve të angazhuar në ZMM – 1
2. Numri i trajnimeve rreth kornizës ligjore – 0
3. Numri i trajnimeve sipas fushës mjedisore – 0

KORNIZA LIGJORE

Metodologjia e EC-it, merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, të cekura më lartë.

Komuna e Ferizajt, përkatësisht ZMM ka raportuar se mbështetet në këto dokumente ligjore:

1. Ligjin për Planifikim Hapësinor
2. Ligjin për Mbrojtje të Mjedisit
3. Ligjin për Menaxhimin e Mbeturinave
4. Ligjin për VNM (Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis)
5. Ligjin për VSM (Vlerësimi Strategjik Mjedisor)
6. Ligjin për Ujërat
7. Ligjin për Inpektim etj

Zyrtarët e ZMM të Komunës së Ferizajt kanë shprehur bindjen se korniza ligjore mjedisore është pjesërisht e konsoliduar, kurse si mangësi sipas zyrtarit, ka në UA 1/2017 për dhënien e lejeve mjedisore komunale. Sipas tij do të ishte më e përshtatshme që ky udhëzim të plotësohet me disa kompetenca shtesë për nevoja të qytetarëve, e në këtë mënyrë të lehtësohet aplikimi i tyre për çështje të cilat mund t'i realizojnë në nivelin lokal në vend se të aplikojnë në nivel qendror. Ndërsa sa i përket njohurive të stafit të këtij sektori rreth kornizës respektive ligjore i kanë notuar me 5, nga 1/aspak deri 5/shkëlqyeshëm.

3

HARTIMI, HARMONIZIMI DHE ZBATIMI I DOKUMENTEVE TË PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TË MJEDISIT, PROJEKTEVE DHE MASAVE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Rrjedha e ciklit të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor nuk shquhet për qasje të strukturuar dhe të organizuar. Hartimi i politikave mjedisore kërkon dinamizim me qëllim që ato të përgjigjen nevojave të kohës. Plani Lokal i Veprimit në Mjedis ka skaduar në vitin 2015 dhe nuk është hartuar plani i ri, kurse VNM (Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis) sipas zyrtarit, bëhet vetëm për projektet për Leje Mjedisore Komunale (LMK). Sa i përket projekteve kapitale ZMM nuk janë deklaruar, kurse masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit në vitin 2021 përfshijnë shpalljen e zonave të mbrojtura me Plan Zhvillimor Komunal PZhK. Ndërsa sa i përket strategjive mjedisore lokale, zyrtari ka bërë të ditur se janë të harmonizuara me strategjitë qendrore.

Planet e nivelit lokal për menaxhimin mjedisor

Lloji i planit	Emri i dokumentit	Statusi	Koha e hartimit	Kohëzgjatja e mandatit	Hartuesi	Disponueshmëria e raporteve të zbatimit
Planet Lokal i Veprimit në Mjedis	"Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2009-2015 Komuna Ferizaj"	Miratuar	2009	6 vite, nga viti 2009 deri në vitin 2015	2 donatorë	Po
Programet Mjedisore <small>(specifiko programet në fushën Emri i dokumentit)</small>	/	/	/	/	/	/
Vlerësimi Strategjik Mjedisor <small>(specifiko planet, programet për të cilat hartohet VSM në fushën Emri i dokumentit)</small>	Planin Zhvillimor Komunal (PZhK) dhe Hartën Zonale Komunale (HZK)	/	/	/	/	/
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis <small>(specifiko projektet në fushën Emri i dokumentit)</small>	VNM bëhet vetëm për projektet për Leje Mjedisore Komunale (LMK)	/	/	/	/	/
Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave	Po	/	/	/	/	/
Plani Zhvillimor Komunal	Planin Zhvillimor Komunal (PZhK)	Miratuar	2017-2025	8 vite	Kompani private	Po
Harta Zonale e Komunës	Hartën Zonale Komunale (HZK)	Proces	/	/	/	/
Plani i rregullimit të tokës	Jo	/	/	/	/	/
Programi për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave	Jo	/	/	/	/	/

Masat e nivelit lokal për mbrojtjen e mjedisit

Masat	Masat konkrete	Statusi	Periudha e realizimit	Entiteti përgjegjës	Lokacioni	Fusha tematike	Plani/Vendimi
Masat për rregullimin e pellgjeve lumore në zonat urbane;	Jo	/	/	/	/	/	/
Masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve	Jo	/	/	/	/	/	/
Masat për mbrojtjen e vlerave të natyrës që shpall Komuna	Me plan zhvillimor komunal PZhK janë shpallur Zonat e Mbrojtura	/	/	/	/	/	/
Masat emergjente për të normalizuar gjendjen e cilësisë së ajrit	Jo	/	/	/	/	/	/
Masa të tjera për mbrojtjen e mjedisit	Jo	/	/	/	/	/	/

4 MBIKËQYRJA INSPEKTIVE DHE RAPORTIMI MJEDISOR

Komuna e Ferizajt ka raportuar se inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit dhe hartimi i raporteve përkatëse realizohet.

Sipas ZMM, inspektorët e komunës së Ferizajt vazhdimisht hartojnë raporte për zbatim të kornizës ligjore dhe raportojnë një herë në vit në MMPHI (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës). Poashtu, në bazë të kërkesave të cilat i pranojnë, ata hartojnë edhe raporte për OJQ-të, të cilat angazhohen për mbrojtje të mjedisit, si dhe për zbatimin e udhëzimit për ndëshkime me gjoba mandatore.

Gjendja e deponive të mbeturinave monitorohet vazhdimisht. Në Komunën e Ferizajt gjindet një deponi e mbeturinave e cila përdoret si deponi tranzite, në fshatin Gërlicë, dhe pas grumbullimit të mbeturinave në baza ditore ato transportohen në deponitë regjionale në Gjilan. Këto deponi, janë monitoruar në bashkëpunim me Agjencionin për Mbrojtje të Mjedisit dhe në kuadër të programit për mbështetje të komunave nga GIZ-i, e në këtë mënyrë sipas zyrarit, janë eliminuar të gjitha deponitë ilegale në komunën e Ferizajt.

Sa i përket monitorimit të gjendjes së zonave të mbrojtura, ky dikaster ka bërë të ditur se vazhdimisht monitorohen zonat e mbrojtura. Në rastet kur pranojnë ankesa nga qytetarët për ndonjë faktor që synon t'i dëmtojë këto zona, ZMM reagon menjëherë duke intervenuar. Ndërsa për monitorimin e gjendjes së pyjeve nuk janë deklaruar.

Sa i përket çrregullimeve mjedisore, zyrtari ka deklaruar që vazhdimisht hasin në çrregullime mjedisore të shkaktuara nga persona të papërgjegjshëm, e të cilat kryesisht kanë të bëjnë me ndotjen e ujërave, tokës, pyjeve etj.

Me rastet e tejkalimit të eksploatimit të resurseve natyrore mbi kushtet e lejuara, ky dikaster kanë bërë të ditur se janë identifikuar disa raste. Rast konkret është ai i kompanisë “Veli Comerc”, e cila bënë eksploatim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në Jezerc.

Në Komunën e Ferizajt, përgjatë vitit 2021 nuk janë identifikuar shkelje në menaxhimin e burimeve drusore, jodrusore dhe faunës së egër si dhe nuk janë identifikuar tejkalime të kushteve të vendgjuetive.

KRIJIMI, GRUMBULLIMI, MENAXHIMI I TË DHËNAVE DHE SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË DHËNAVE

Komuna e Ferizajt në vitin 2021 nuk ka pasur sistem të monitorimit të cilësisë ajrit, dhe as mbikëqyrje sistematike të cilësisë së ajrit.

Kjo komunë, poashtu nuk ka pasur as sistem të monitorimit të dheut, kurse cilësinë e ujit në komunën e Ferizajt, e mbikëqyrin Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në Ferizaj dhe kompania regjionale e ujit “Bifurkacioni”.

Sa i përket parashikimit dhe paralajmërimit të hershëm të vërshimeve dhe thatësirave, është bërë e ditur se nuk realizohet.

Sipas zyrtarëve komunalë, ZMM-ja nuk ka kapacitete të nevojshme teknike e as njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore, pasi që në ZMM siç është cekur më lartë që është i angazhuar vetëm 1 zyrtar.

BASHKËPUNIMI, KOORDINIMI DHE PJESËMARRJA PUBLIKE

Zyrtarët përgjegjës të Komunës së Ferizajt bashkëpunimin dhe koordinimin me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore e kanë vlerësuar si të pamjaftueshëm. Ngjashëm është vlerësuar edhe bashkëpunimi dhe koordinimi me nivelin qendror sa i përket hartimit të strategjive mjedisore.

Sipas tyre niveli i bashkëpunimit me organizatat joqeveritare sa i përket zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme është në nivel mesatar.

Sa i përket pjesëmarrjes publike gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor, Komuna e Ferizajt ka zhvilluar proces me pjesëmarrje publike për PZhK (Plani Zhvillimor Komunal), PRRU (Plani Rregullues Urban), PZhu (Plani Zhvillimor urban) dhe HZK (Harta Zonale Komunale).

Kurse pjesëmarrjen publike në procese të tilla e vlerësojnë me notën 3, nga 1/aspak e kënaqshme deri 5/shumë e kënaqshme.

LICENCIMI DHE LEJET MJEDISORE

Sipas të dhënave të paraqitura nga ZMM në vitin 2021 janë lëshuar gjithsejtë 48 LMK (Leje Mjedisore Komunale), dhe nuk është lëshuar asnjë licencë për çështje mjedisore nga niveli lokal.

PËRFUNDIME

Gjetjet e këtij raporti janë validuar nga zyrtarët përkatës komunalë, duke pohuar se ato pasqyrojnë gjendjen reale në sektorin e mjedisit, bashkë me mundësitë për të ngritur dhe përmirësuar çështjet mjedisore në këtë komunë. Burimet njerëzore dhe financiare sipas tyre nuk janë të nivel të mjaftueshëm, gjë që mbase reflektohet edhe në gjendjen aktuale mjedisore.

Bazuar në këtë monitorim, dalin konkluzionet se:

Në Komunën e Ferizajt organi përgjegjës për planifikim dhe menaxhim mjedisor është Zyra për Mbrojtjen e Mjedisit që funksionon në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit dhe e Mjedisit, por kapacitetet njerëzore brenda këtij organi janë të pamjaftueshme si në aspektin kuantitativ ashtu edhe në atë profesional, ndërkohë që nuk ka pasur as aktivitete për fuqizimin e tyre në raport me kornizën aktuale ligjore dhe në periudhën raportuese nuk është organizuar asnjë trajnim rreth çështjeve mjedisore për stafin e ZMM.

Shkalla e hartimit dhe zbatimit të politikave lokale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor mbetet problematik, për faktin se nuk ka organizim të mirëfilltë në këtë aspekt; përkatësisht, rrjedha aktuale e hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit aktualisht e bën të vështirë matjen e efikasitetit të këtyre veprimeve në përmirësimin e gjendjes mjedisore.

Niveli i inspektimit si dhe hartimi i raporteve përkatëse lidhur me zbatimin e kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit dhe të zbatimit të strategjive mjedisore mbetet i paqartë për shkak të mos shpалosjes së të dhënave në këtë drejtim.

Bashkëpunimi ndërinstytucional në hartimin e politikave publike vlerësohet të jetë i pamjaftueshëm. Ngjashëm është vlerësuar edhe bashkëpunimi me shoqërinë civile në hartimin e politikave lokale i cili mbetet i pamjaftueshëm. Kurse pjesëmarrjen publike gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor e kanë vlerësuar me notën 3, nga 1-aspak e kënaqshme deri 5-shumë e kënaqshme.

Sipas të dhënave të paraqitura nga ZMM në vitin 2021 janë lëshuar gjithsejtë 48 LMK (Leje Mjedisore Komunale), dhe nuk është lëshuar asnjë licencë për çështje mjedisore nga niveli lokal.

REKOMANDIMET

- Të shqyrtohen mundësitë për shtimin e punonjësve profesionistë në ZMM.
- Të organizohen trajnime për punonjësit e ZMM rreth kornizës ligjore dhe rreth çështjeve mjedisore.
- Të përmirësohet dhe dinamizohet hartimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit.
- Planet e nivelit lokal për menaxhimin mjedisor të përditësohen, bashkë me fuqizimin e raportimit të zbatimit të tyre.
- Të rriten kapacitetet si dhe të shtohet mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor.
- Të avancohet bashkëpunimi nivel qendror-lokal në hartimin e akteve ligjore dhe strategjive mjedisore.
- Të kultivohet bashkëpunimi më i afërt me OJQ-të për të nxitur rritjen e pjesëmarrjes së publikut në çështjet mjedisore.

PËR EC:

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme:

1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale,
2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe
3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente:

1. Gjithëpërfshirjen,
2. Qëndrueshmërinë, dhe
3. Dijen.

EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë lart.

Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme.

Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;

2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;
4. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.